



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
NDERMARRJA E SHERBIMEVE PUBLIKE FIER
NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. _____ Prot.

Fier, më _____02.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: **“BLERJE VAJRA TE MJETEVE”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Lubrifikantet 24951100-6

VLERA E FONDIT LIMIT: prej **2 997 353.33** (dy milion e neneteqind e nentëdhjetë e shtatë mijë e treqind e pesëdhjetë e tre pike tridhjetë e tre) **lekë pa TVSH** dhe **3 596 824** (tre milion e pesëqind e nentëdhjetë e gjashtë mijë e teteqind e njetzet e kater) **lekë me TVSH**, vënë në dispozicion nga Buxheti i Ndermarrjes së Sherbimeve Publike Fier.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Ndermarrja E Sherbimeve Publike Fier ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

.....

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas Shtojcës 9*

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar në nenin 82 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën është përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si

provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”

b. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (**2023, 2024**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më pak se **1 000 000 leke pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetor që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës.; në pikën 1 dhe pikën 2/c të nenit 43 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontratën, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vite të fundit financiare. Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar;

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kërkuara, se zoterojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën sic është parashikuar nga AK. Kriteri i mesipër është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/c e nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 *“Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”* i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohe në Procedurën e Hapur e thjeshtuar, perkatesisht; Pika 2/c: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohe operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar*; Duke qene se kjo procedure prokurimi është bazuar në vlerën e fondit limit nën kufirin e ulët monetar, AK duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara me pare gjykon se është e pershtatshme vendosja e kriterit të marzheve maksimale të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 *“Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”* i ndryshuar ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin Mbi të Ardhurat”* i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; Njesia e prokurimit ka gjykuar të nevojshme përcaktimin e dy viteve të fundit në përputhje me vlerën e fondit limit të parashikuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit. Në këtë rast vlera e kërkuar është jo më pak se **500 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet), që është realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për këtë pike Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një nga dokumentat e mëposhtem:

- a-** vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b-** Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe

të deklaruar në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar, nenit 40, pika 4 dhe nenit 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”* i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se **500 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet) që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar, piken 4 të nenit 40 dhe piken 4/b të nenit 55 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 *“Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”* i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë teknike të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet përvojës së mëparshme, se zotërojnë kapacitet dhe aftësinë teknike për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga AK.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë / broshurë / skedë teknike të prodhuesit ose fragmente të tyre, për të gjithë artikujt objekt prokurimi ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalog/ broshurë/ skedë teknike (për lehtësi identifikimi) artikujt dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria e tyre me dokumentet e tenderit. Në rastin kur katalog/broshurë ose fragment katalogu ose broshurë është në gjuhën shqipe, nuk ka nevojë të përkthet dhe noterizohet por në rastin kur është në gjuhë të huaj duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar.

Argumentimi: Vendosja e kriterit të sipërcituar është vënë në mbështetje të nenit 40 pika 6 gërma b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar parashikohet shprehimisht: Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogjet teknike

Paraqitja e katalogëve të prodhuesve është e nevojshme në funksion të verifikimit të përputhshmërisë së produkteve me specifikimet teknike të AK me qëllim realizimin e kontratës me sukses.

Paraqitja e katalogjeve për zërat e mallrave, është kërkuar me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së mallrave që operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike të përcaktuara në DST.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar dhe argumentuar nga grupi i punës dërguar me shkresën nr.112/4 prot date 13.02.2026, si dhe në përputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të ligjit nr.162/2020, “*Per Prokurimin Publik*”, nenin 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar. Kriteret teknike të veçanta të kualifikimit lidhur me kapacitetin teknik janë hartuar e argumentuar nga grupi i punës.

Bashkelidhur DST në SPE.

Specifikimet teknike nuk kanë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë marke apo emri të vecantë, patente, vizatim ose tip ose origjinë ose prodhim specifik, përveç kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme e saktë ose e kuptueshme e përshkrimit të kërkesave me kusht që fjala “ose ekuivalent” përfshihet detyrimisht në keto specifikime.

Shënim: *Në çdo rast kur në specifikimet teknike dhe preventive mund të jete përdorur si referencë emri i ndonjë marke apo emri të vecantë, patente, vizatim ose tip ose origjinë ose prodhim specifik, përfshihet dhe fjala “ose ekuivalent” i saj.*

Njësia e Prokurimit:
